

VENDIM
Nr.574, datë 8.12.1999

**PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË PËR DISA PUNIME EMERGJENTE NË
ARGJINATUR[N E ZARANIKËS, NË ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurim publik”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Bashkisë së Elbasanit, t’i shtohet në buxhetin e vitit 1999, në zërin “investime” 8 milionë lekë, për përfundimin e punimeve në argjinaturën e Zaranikës.
 - 2.Efektet financiare të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave
 - 3.Autorizohet Bashkia e Elbasanit, si investitorë, për prokurimin e fondit prej 8 milionë lekësh, me procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë me shoqërinë AGET, e cila i ka në proces këto punime.
 - 4.Ngarkohet prefektura e Elbasanit për kontrollin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës, në përputhje me afatin e parashikuar, për përfundimin e objektit, drejtimin e punimeve dhe kolaudimin e tyre, deri në marrjen në dorëzim.
 - 5.Punimet për ndërtimin e objektit të përfundojnë brenda datës 30.12.1999.
- ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Ilir Meta